



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.80/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi kryesues, Kujtim Pasuli dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës PDK, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 22.01.2025, merr këtë:

#### V E N D I M

**Hedhen të pasafatshme** ankesat Anr.80/2025, Anr.81/2025, Anr.82/2025 dhe Anr.83/2025, të paraqitura nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

#### A r s y e t i m

Me datë 21.01.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesat e identifikuara me numër Anr.80/2025, Anr.81/2025, Anr.82/2025, dhe Anr.83/2025, të parashtuara nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës PDK, me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ku në ankesën Anr.80/2025 subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) pretendon se Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, me datë 13.01.2025 gjatë një tubimi të organizuar nga kjo parti ka deklaruar: *“Po vjen dita kur kemi nevojë për një brez të ri të biznesmenëve prodhues, përtej këtyre që u pasuruan prej tranzicionit. Jo më aso biznesmenësh që milionin e parë e kanë nga koha e Serbisë apo nga koha e Klanit Pronto”* me çka sipas parashtruesit të ankesës i njëjti barazon dhe krahason PDK-në me Serbinë.

Në ankesën Anr.81/2025, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) pretendon se Kryetari i LVV, më datë 12.01.2025, gjatë një tubimi të organizuar nga kjo parti, ka deklaruar: *“Premtimet e këtyre tjerëve i ngjajnë hajnit i cili do me ta vjedhë shtëpinë por ta premtton një*

*bakshish. Kur i dëgjoni ata duke ju premtuar, dijeni që ata duan ta lënë bakshishin pasi ta vjedhin shtëpinë. Por ka kalu koha kur ata bëjnë sfilatë në pushtet e vjedhin shtëpinë e popullit. Opozita e ka vendin më së shumti në opozitë. Dhe a e dini pse ata nuk vijnë dot më në pushtet? Për shkak të popullit, për shkak të popullit që kurrë nuk i shërbyen me nderë dhe asnjëherë nuk e kuptuan taman”*

Në ankesën Anr.82/2025, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) pretendon se Kryetari i LVV, më datë 12.01.2025, gjatë një tubimi të organizuar nga kjo parti, ka deklaruar; *"Në popullsinë e në shoqërinë tonë, në politikën e në institucionet tona, nuk ka krah të luftës e krah të paqes se shqiptarët gjithmonë kanë luftu prej zorit e jo për qef. Por ka të krahut materialist të luftës dhe të krahut idealist të luftës e ata të krahut idealist të luftës janë në lëvizje si ngaherë, si përherë, si gjithnjë, si përgjithmonë. Rilindasi ynë i madh, ndër rilindasit e fundit, Faik Konica, ka thënë një shprehje lapidare, i ka shumë të tilla por unë për zgjedhja një të tjetër. Duke cituar: Shqiptarët nuk ndahen në të krishterë e në muhamedanë, po ndahen në dy anë: ana e kombëtarëve, në të cilën ka shqiptarë nga të gjitha besimet, dhe ana e zuzarëve. Ne jemi nga ana e kombëtarëve"*

Në ankesën Anr.83/2025, subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) pretendon se Kandidati i LVV, Xhelal Sfeqla, më datë 15.01.2025, në tubim të LVV ka deklaruar: *"Sot në ditën e Masakrës së Reçakut nga vendi i masakrave të familjes Bogujevci e Duriqi, pyes disa bërlllok të partive opozitare: Si keni fytyrë që Policinë e Kosovës ta krahasoni me Policinë e Millosheviqit? Të pafytyrë". "Ne me mbështetjen tuaj të fuqishme liruam Kosovën nga këto mbetje, e forcuam atë ekonomikisht e politikisht, si ata që jo vetëm lejonin e legjitimonin, por edhe bashkëpunonin me terroriste. Në ankesat e paraqitura nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës pretendohet se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje ka vepruar në kundërshtim me Ligjin Nr. 08/1--228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, nenin 34, paragrafin 1.11, i cili përcakton: "Përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt dhune kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve, ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo lloj materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tille.*

Më datë 21.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 22.01.2025.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, i konteston pretendimet e paraqitura nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës PDK, me kërkesë që ankesat të hedhen si të pasafatshme dhe të palejuara.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.80/2025, A.nr.81/2025, A.nr.82/2025 dhe A.nr.83/2025 të paraqitura me datë 21.01.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.80/2025, për shkak të

natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesve.

Paneli pas vlerësimit të afatshmërisë së ankesës, gjeti se:

### **Ankesat janë të pasafatshme**

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesave, ka gjetur se ankesat e parashtruara nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje të datës 21.01.2025, janë parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 39 paragrafi 3 i LZP-së, i cili përcakton se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj, si dhe neni 13, paragrafi 3, nen paragrafi 3.3 i Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se “PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.3. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.*

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, rezulton se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesat në PZAP, më datë 21.01.2025, ku ka pretenduar se subjekti politik LVV, ka përdorur një fjalor që është në kundërshtim me nenin 34, paragrafi 1.11 të LZP-së, gjatë tubimeve të mbajtura në datat 12.01.2025, 13.01.2025 dhe 15.01.2025. Megjithatë, ankesat janë paraqitur pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesave, sipas nenit 39, paragrafi 3 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesave është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe ankesa është dorëzuar më 21.01.2025, ndërkohë që tubimet në fjalë janë mbajtur më 12.01.2025, 13.01.2025 dhe 15.01.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Paneli gjeti se të njëjtat janë ushtruar pas afatit ligjor, dhe nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 39 paragrafi 3, nenit 115 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nen paragrafi 5.5 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A.nr. 80/2025 me datë 22.01.2025

**Kryesues i Panelit**

**Bujar Muzaqi**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.